

Seminari i Fushës Frojdiane në Shqipëri
Rrethi Lakanian Shqiptar



A janë teoritë seksuale
të fëmijës ende aktuale?

Dr Daniel Roy

22 Shtator 2018
9h00-14h00
Biblioteka Kombëtare
Salla Franceze



L'ASSOCIATION DE LA FONDATION DU CHAMP FREUDIEN

74, rue d'Assas - 75 006 Paris

Tél : 01 45 48 56 72 – Fax : 01 45 48 79 38

SEMINARI I FUSHES FROJDIANE NE SHQIPERI

Paraqitje e përgjithshme

Seminari do të mbahet nga lektori i Fushës Frojdiane, **Dr Daniel Roy** anëtar i Shoqatës Botërore të Psikanalizës (A.M.P.).

Ky cikël seminaresh organizohet nga Sekretariati i Fushës Frojdiane për Europën Lindore.

Sesioni i parë do të zhvillohet në 21-22 Shtator 2018 nga **Dr Daniel Roy**, psikanalist në Bordeaux.

Organizuar nga sekretariati i NLS-Est

Regjistrimet kryhen në adresën elektronike seminaret_e_psikanalizes@nyjelakim.net
Tarifa hyrëse për seminarin – 2000 lekë, për studentët nën 26 vjeç – 1000 lekë.

Për më shumë informacione vizitoni faqen tonë zyrtare www.nyjelakim.net

SEMINARI I FUSHES FROJDIANE NE SHQIPERI

Sesioni i parë

ARGUMENTI

A janë teoritë seksuale të fëmijës ende aktuale?

Në 1905, Frojdi shkaktoi skandal me publikimin e *Tre eseve mbi teorinë seksuale* në veçanti në esenë e dytë që trajton « seksualitetin fëmijënor ». Keqkuptimi madhor midis psikanalizës dhe shoqërisë së epokës nis që këtu! Kjo ndodh pavarësisht saktësimeve që bën Frojdi : jo nuk bëhet fjalë t'i mvishet një kuptim « seksual » çdo ndodhie të jetës : përkundrazi psikanaliza bazohet vetëm mbi atë që thonë subjektet, në rastin tonë fëmijët dhe fëmijët dëshmojnë mbi « teoritë » e tyre të ardhjes në jetë të një fëmije, mbi dallimin e gjinive, etj...

Por ky skandal a është sërish aktual në ditët e sotme dhe a interesohen ende psikanalistët mbi teoritë seksuale të fëmijërisë?

A nuk përfshihet seksualja në diskursin e përditshëm nëpërmjet shtegut imagjinar të strukturuar paraprakisht nga lojrat video, filmat vizatimorë, superheronjtë dhe heroinat?

Ne do të shqyrtojmë, nëpërmjet Lacan-it, se si psikanaliza konsideron që teoritë, d.m.th. fikSIONET e ndryshme që përpunon një subjekt për t'i dalë mbanë urgjencës së jetës, kanë gjithmonë një përmbajtje « seksuale » në thelbin e tyre dhe se « seksualiteti » nuk është gjë tjetër veçse pamundësia e gjuhës për të thënë tërësinë e qenies njerëzore.

Në këto kushte, seksualja ndjek rrugë të tjera nga ato të fikSIONIT, të « teorisë » dhe pushton funksionet e ndryshme të trupit dhe të mendjes, nga kanë zanafillën shumësia e « simptomave të reja » tek fëmija e shekullit tonë : hiperaktiviteti, vëmendja dhe sjellja e turbulluar, çrregullimet konjitive të ndryshme etj.

Dr Daniel Roy

Bibliografia

Frojdi: *Tre ese mbi teorinë seksuale*, Phoenix, Tiranë

Lacan: *Mësimet e mia*, Onufri, 2012, Tiranë, fq. 28-36

Lacan: *Seminari XI, Les quatre concepts fondamentaux de la psychanalyse*, [Katër konceptet themelore të psikanalizës] fq. 62 (fr.) (leksioni i datës 12 shkurt 1962 përgjigje e Lacan-it ndaj komentit të Françoise Doltos)

PROGRAMI

08h50 - 09h00 : Regjistrimi i pjesëmarrësve

09h00 - 09h10 : Përshëndetje e pjesëmarrësve dhe ndërhyrje me temë: *“Seksualiteti është gjithmonë traumatik”* nga **Jolka Penotet**, Presidente e Rrethit Lakanian Shqiptar

09h15 - 10h00 : *“Grupi i leximit kundër shfletimit”* Disiplinë e komentit të tekstit *“Mësimet e mia”* (Jacques Lacan), fq. 28-36 nga **Eva Filaj**

10h00 - 12h00 : Konferencë nga **Dr Daniel Roy**: *“A janë teoritë e seksualitetit të fëmijës ende aktuale?”*

12h00 - 12h15 : Pyetje dhe diskutime nga pjesëmarrësit

12h15 - 12h30 : *Pushim - Kafe*

12h30 – 12h50 : Prezantim rasti klinik *“Çi(k)buk”* nga **Albana Xhemali**

12h50 - 13h30 : Pyetje dhe diskutime mbi rastin

13h30 - 14h00 : Përfundime dhe perspektiva klinike nga **Dr Daniel Roy**